



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT



**Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[ëëë.avokatipopullit.gov.al](http://ëëë.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot. Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2014  
Nr. Dok. 201401358/2

**Lënda:** *Rekomandohet përmirësimi i kushteve të trajtimit të të paraburgosurve në I.E.V.Penale Tropojë.*

**Drejtuar:** **Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve  
Z. Artur Zoto**

**TIRANË**

**Drejtorit të I.E.V.Penale  
Z. Granit Kurmeka**

**TROPOJË**

**Të nderuar Zotërinj,**

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, kreu një inspektim të përgjithshëm në Institucionin e Paraburgimit Tropojë, më dt. 20.06.2014. Në përbërje të grupit inspektues bënë pjesë Alfred Koçobashi (drejtues i grupit inspektues), Irena Taga, Alma Alibali (mjeke)N/Komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës së bashku me ekspertët e Shoqatës Perthyerje, në zbatim të marrveshjes së bashkëpunimit të Institucionit të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar Parandalues në kuadër të *OPCAT-it* me OJQ-të .

Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të paraburgosurve, Avokati i Popullit ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si vijon:

Sipas urdhrorit të Ministrit të Drejtësisë, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Tropojë, kategorizohet institucion paraburgimi.

Në përgatitjen e këtij raporti, nga grupi monitorues u përdor informacioni i mbledhur në I.E.V.P. Tropojë nga kjo vizite, nga kontakti me drejtuesin e institucionit dhe përfaqësues të tjerë të administratës së këtij institucioni, nga

kontakti me vetë të paraburgosurit, vizita në ambiente të brendshme të paraburgimit, nga verifikimi i të dhënave në rregjistrat dhe dosjet e I.E.V.P.-së, si dhe nga krahasimi i këtyre të dhënave me kërkesat e aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

### **Shënime paraprake**

Vizita pranë institucionit të paraburgimit Tropojë shënoi vizitën e radhës së grupit të monitorimit të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës sipas planit të punës miratuar nga Avokati i Popullit. Vizita monitoruese pranë këtij institucioni u zhvillua në një frymë tepër të mirë bashkëpunimi. Nga Drejtori i Institucionit na u ofrua mundësia që të kishim akses brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që duhet të vizitonim. Objektivi kryesor i vizitës monitoruese ishte vlerësimi i kushteve dhe trajtimi i personave të paraburgosur.

Në viziten e tij, grupi i monitorimit u njoh dhe vizitoi, ndërtesën aktuale të Institucionit të paraburgimit si dhe ndërtesën e re të institucionit të paraburgimit, kjo e fundit ende jo në përdorim. Nga kontakti me autoritet drejtuese të IEVP Tropojë, na u bë e ditur se punimet në godinen e re kishin përfunduar dhe së shpejti kjo godinë do merrej në dorëzim nga autoritetit e institucionit. Kjo godinë duhej të kishte përfunduar dhe të ishte dorëzuar brenda muajit shtator 2013<sup>1</sup>, por nga monitorimi u konstatua se ende në gjendje pune ishte vetëm paraburgimi në godinën e vjetër. Kjo e fundit, në kushtet e një amortizimi të plotë dhe e papërshtatshme, nuk kishte ndryshuar në asnjë drejtim me atë të konstatuar në monitorimin e grupit monitorues të bërë në vitin 2013.

Edhe në këtë monitorim, qëllimi i vizites se grupit monitorues, përfshiu verifikimin e përmbushjes së standardeve si në godinën aktuale, ashtu edhe në godinën e re ende jo në gjendje pune, keshtu që edhe ky raport përfshin konstatimet e grupit monitorues në të dyja godinat.

Gjatë inspektimit të Komisarariatit të Policisë Tropojë, nga Shefi i Rendit të këtij komisarati, grupit të inspektimit ju bë me dije se ky komisarati kishte 3 dhoma sigurie, të cilat në bazë të një marrëveshjeje me IEVP Tropojë, ndodheshin në mjediset e këtij të fundit. Ekspertët u informuan se në këtë IEVP, përkrah efektivëve të policisë së burgjeve, ishin edhe efektivët e Policisë së Shtetit. Një fakt i tillë nuk u konstatua nga ekspertët gjatë monitorimit në IEVP Tropojë, institucion i monitoruar në të njëjtën ditë nga i njëjti grup monitorimi. Megjithatë, ekspertët kërkuan kopje të marrëveshjes së përmendur nga ana e Shefit të Rendit të Komisarariatit të Policisë Tropojë, e cila u vu menjëherë në dispozicion të grupit të inspektimit. Akt-Marrëveshja mes Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë “Mbi kalimin e ambienteve të paraburgimit dhe ndihmëse në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, nr. 5740, datë 03.10.2007, dhe më pas akt-marrëveshja e nënshkruar nga Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në zbatim të akt-marrëveshjes së sipër-cituar mes dy Ministrive, nr. 1414, datë 01.09.2007, përcakton se mjediset e kaluara në vartësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve janë:

---

<sup>1</sup> Shif raportin e monitorimit të vjetshëm për IEVP-ne Tropoje

1. Godina e Repartit të Policisë së Rendit 2 katesh me të gjitha ambientet e saj;
2. Sheshi para godinës (lulishtja e pasme);
3. Sipërfaqja sipër godinës, deri para Stacionit të PMNZSH Tropojë;
4. Ambientet e kuzhinës së policisë.

Siç edhe shihet më lartë, në asnjërin prej akt-marrëveshjeve nuk bëhet fjalë për situatën e bashkë-administrimit të dhomave të sigurisë së Komisarariatit të Policisë Tropojë brenda mjediseve të IEVP Tropojë. Për më tepër, një fakt i tillë i cili nuk u raportua dhe nuk ju bë me dije ekspertëve të MKPT-së gjatë takimit me drejtuesit e IEVP-së Tropojë.

### **Të dhena të përgjithëshme mbi godinen e vjetër (aktuale) të paraburgimit Tropoje**

Gjatë takimit me Z. Kurmekaj drejtorin e IEVP-së grupit monitories ju dha informacion i detajuar mbi institucionin i cili informoi se godina e re ka përfunduar dhe pritet që shumë shpejt të bëhet dhe transferimi i të paraburgosurve drejt godinës së re gjë e cila është penguar për mungesë fondesh pasi mungojnë të gjitha bazat materiale për arredimin e dhomave dhe ambjenteve të tjera. Ai pohoi se aktualisht në I.E.V.P. gjëndeshin vetëm 4 të paraburgosur, mes tyre asnjë të mitur, person të huaj apo person me probleme të shëndetit mendor. Njëri prej të paraburgosurve është i sëmurë kronik por që i janë plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme sipas kërkesës së tij dhe rekomandimit të mjekut. Ky institucion ka një kapacitet prej 24 shtreterish. Si probleme kryesore të evidentuara nga drejtori i institucionit janë: ambjentet e vjetra dhe të amortizuara të I.E.V.P-së, mos kalimin në ambjentet e institucionit të ri i cili ka përfunduar dhe mungesën e skemës së rimbursimit të ilaçeve. Kjo ka sjellë që të paraburgosurit me probleme shëndetësore të paguajnë vetë për medikamentet e tyre. Organika e institucionit është e plotësuar. Gjithsej 48 të punësuar. Nuk ka asnjë person me masa disiplinore që nga viti 2012.

Gjithesej institucioni i paraburgimit kishte 11 dhoma nga të cilat 2 përdoreshin nga Komisarati i Policisë Tropojë. Nga 11 dhoma, 8 prej tyre janë dhoma për një person, ndërsa 2 dhoma me nga 4 krevate secila, dhe 1 dhome veçimi. Në parantezë, edhe vetë godina e paraburgimit gjendet brenda territorit të Komisarariatit të Policisë Tropojë. Të paraburgosurit e strehuar në dhoma për një person flinin sipër një dërrase (mbi të cilën qëndronte dysheku) e vendosur kjo në lartësi 10 cm nga toka.

Nga personat e paraburgosur nuk kishte të mitur ose të kategorise 18-21 vjeçarë. Në momentin e monitorimit nuk kishte persona të veçuar. Në paraburgimin e Tropojës, nuk kishte gjithashtu asnjë person të punësuar. Në aspektin e infrastruktures, siç e përmendëm më sipër, kjo ndërtesë është e papërshtatshme dhe jashtë standardeve për funksionin për të cilin ekziston.

## **Të dhëna të përgjithshme mbi godinen e re (jo funksionale) të paraburgimit Tropojë**

Në kohën e kryerjes se ketij monitorimi, godina e re e paraburgimit të IEVP-së Tropojë, ishte ende e pashfrytëzueshme. Të shoqëruar nga autoritet e paraburgimit Tropojë, na u prezantuan ambientet e paraburgimit, të cilat në pjesen me të madhe ishin gati (të përfunduara) për funksionin që do të kryenin. Ndërtesa e re do të ketë një kapacitet maksimal për 26 persona. Në këtë ndërtesë janë parashikuar gjithsej 8 dhoma për të paraburgosurit, 6 prej të cilave me 4 krevate, 1 me dy krevate dhe një dhoma veçimi me dy shtretër. Në momentin e monitorimit dhomat e sipërpermendura ishin pajisur me shtretërit e sipërpermendur sipas ndarjes se treguar me lartë. Sipas informacionit të marre nga punonjësit e institucionit të cilat na shoqëruan në godinen e re, dhomat dyshe do të shërbejnë, njëra si dhomë veçimi, ndërsa tjetra si dhoma observimi. Ndërtesa në fjalë përbëhet nga dy kate dhe një kat pjesërisht nëntokë (nën nivelin 0) vetëm nga njëri krah. Ky i fundit kishte dalje drejtë për së drejti mbi tokë (nga krahu tjetër), jashtë godinës pasi vetë ndërtesa ishte e pozicionuar mbi një pjesë kodrinore. Në këtë kat, pjesërisht nëntokë, ishin të projektuara disa ambiente, që sipas shpjegimeve të marra nga punonjësit e institucionit, njëri do të shërbente për guzhinë ose për vendosjen e kaldajes (ende nuk ishte percaktuar saktë) ndërsa tjetri do të përdorej për magazininë (edhe ky i percaktuar sakte pasi si magazinë mund të përdorej edhe një ambient në katin e parë (nivel mbi 0) i ndodhur menjëherë në krahun e djathtë në hyrjen e katit të parë.

Në katin e parë të ndërtesës, e cila ishte terësisht mbi nivelin 0, ishte projektuar, dhoma e takimit me familjaret dhe avokatin, vendqendrimi i forcave të ndërhyrjes së shpejtë, një ambient për magazine (i permendur me lart i cili mund të shfrytëzohej edhe për kaldaje) dhe rregjimi i brendshëm. Në rregjimin e brendshëm, siç e përmendëm kishte 6 dhoma për 4 persona dhe 2 dhoma për 2 persona, ambientet e dushit (nga dy poste të ndara që siguronin mirë privatsinë) si dhe dalja për në ajrim. Hapësira e ajrimit ishte e vogël, në prespektivën e organizimit të lojrave, pasi edhe kjo hapësirë ishte e ndarë në dy poste të veçuara.

Dhomat ishin të pajisura me lavaman dhe WC, ku kjo e fundit ishte e ndarë me mur, por ende pa derë. Sipërfaqja që zinte ambienti i W.C. ishte: 1.5 m<sup>2</sup>

(1 m x 1.50 m). Dhomat ishin të pajisura me krevate, sipas kapacitetit, 4 shtretër tip marinari, dhe 2 shtretër tip marinari.

U matën permatat e dhomave, të cilat ishin standarte sipas kapacitetit pritës, e konkretisht : për dhomat me kapacitet për 4 persona 4m x 4m x 2.80m (duke inkuadruar këtu edhe hapësirën e ndarë me mur të WC). Sipërfaqja e banimit e llogaritur për person në dhomat për 4 veta është 4 m<sup>2</sup> per person. Deri këtu sipërfaqja e banimit është konforme standartit të kërkuar, por po t'i heqim kësaj sipërfaqe, sipërfaqen e ambientit të banjës, sipërfaqja e banimit ulet nën këtë standart. Vëllimi i ambientit të banimit të dhomave me 4 persona, është 11.2 m<sup>3</sup> për person, që do të thotë mbi standartin minimum të kërkuar nga ligji. Për dhomat 2-she, permatat ishin si në vijim: 4 m x 2.50m x 2.80 m (duke inkuadruar këtu edhe hapësirën e ndarë me mur të WC). Sipërfaqja e banimit për person, në dhomat e projektuara për dy persona ishin: 5 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi për person (duke integruar edhe sipërfaqen e W.C. prej 1-5 m<sup>2</sup>), ndërsa kurbatura ishte 14

m<sup>3</sup> për person. Në të dyja rastet respektohen keto parametra të kerkuar nga aktet normative në fuqi.

Dhomat e banimit ishin te pajisura me dritare me permasa perafersisht 1.20x60, të sigurura me hekura, të cilat siguronin një ndriçim të bollshëm në dhomat e banimit.

Në katin e dytë të ndërtesës ishin parashikuar ambiente të punës së administratës së institucionit, si dhe sipas informacionit të marrë nga punonjësit e institucionit që na shoqëronin, janë parashikuar gjithashtu, dhomë per bibliotekën dhe sallë kompiuterash.

Në kendvështrimin e ekspertëve të grupit të monitorimit u dukë e pa realizuar mirë nga ana arkitekurore, ndarja e ambienteve në funksion të qëllimit të shërbimeve në institucion. Konkretisht, guzhina, pavarësisht se ende e pafiksuar përfundimisht, ndodhej jashtë rregjimit të brendshëm. Nëse do të fiksohet kështu, transporti i ushqimit nga guzhina në ambientet e brendëshme, do të realizohet në mënyrë fizike, nga jashtë duke u ekspozuar ushqimi në natyrë, gjë që nuk është higjienike dhe brenda kushteve të sigurisë; ushqimi zakonisht transportohet nga të paraburgosur të punësuar, të cilët mund të jenë të pasigurtë për jetën, pasi për të hyrë në guzhinë do t'u duhet të dalin jashtë murit të ngritur për të ulur vëzhgueshmërinë e pallatit përkarshi, duke u berë shënjestra të mundëshme nga pallati në fjalë.

Po kështu, zgjidhja arkitekurore e vendosjes së bibliotekes apo sallës së kompiuterave në katin e dytë, detyrimisht kërkon që të paraburgosurit të cilët do të duan t'i shfrytëzojnë ato, të dalin nga rregjimi i brendshëm për t'u ngjitur sipër në katin e dytë. Kjo mund të sjellë probleme në lidhje me sigurinë e tyre, të jetës apo shëndetit, pasi kati i dytë është i dukshëm nga pallati në fjalë por, nga ana tjetër do të kërkojë edhe marrjen e masave në lidhje me sigurimin e tyre për të evituar tentativat për tu larguar, gjë që kërkon vëzhgim e mbajtje në kontroll të vazhdueshëm të tyre nga forcat e sigurisë në institucion, që do të thotë ndryshe me shumë efektiv policie në institucion.

Nga informacioni i shkëmbyer me punonjësit e institucionit që na shoqëruan në godinën e re, ishte i qarte ambienti i veçimit, por ende ishte i paqarte dhoma e observimit, si dhomë me vehte përsa i përket funksionit. Na u krijua përshtypja, që punonjësit e institucionit të paraburgimit IEVP-së Tropojë, nisur edhe nga përvoja në paraburgimin e vjetër, ku, disa dhoma përdorshin nga Komisariati i Tropojës për të ndaluarit/arrestuarit deri ne 72 orë, përdornin vetëm një dhomë si dhomë veçimi meqë e prezurmonin observimin si të realizuar gjatë periudhës së ndalim/arrestimit, ose edhe për shkaqe të pamundësise faktike te ambienteve në dispozicion, ngrejmë dyshimin e arsyeshëm që ata mendojnë që të bëjnë të njëjtën zgjidhje edhe në këtë godinë të re. Për këtë arsye, rekomandojme percaktimin saktë të një dhome të tillë, duke rekomandur dhomen tjetër për 2 persona si një dhomë observimi.

### **Trajtimi i të paraburgosurve.**

Gjatë monitorimit të grupit monitorues dhe bisedave kofidenciale që u bënë gjatë intervistave me të paraburgosurit nuk u konstatuan raste të përdorimit të forcës fizike, ushtrimit të dhunës, presionit psikologjik apo raste torture. Mardhëniet mes stafit të regjimit të brendshëm dhe atij të edukimit me të paraburgosurit dukej i mirë dhe nuk të linte të dyshoje për keqtrajtim psikologjik apo fizik gjë që u pohua dhe nga vetë të paraburgosurit.

Ankesat që ishin në momentin e inspektimit kishin të bënin më shumë me hapsirën e kufizuar të ajrimit kushtet e tualetit dhe dusheve të cilat ndodheshin të vendosura sëbashku, lagështira dhe mungesë e ndricimit natyral, mungesë medikamentesh mjeksore dhe shërbimit dentar.

## **Infrastruktura/Dhomat e banimit dhe kushtet materiale**

I.E.V.P. Bajram Curri ka një vendosje gjeografike që privon të paraburgosurit nga ndriçimi natyror. Institucioni ka 11 dhoma, një dhomë takimi me familjarët, një dhomë takimi me avokatin, drejtorin, prokurorin dhe ambjentin e ajrimit i kufizuar në hapësirë. Mungon salla e aktiviteteve ku mund të zhvillohen programe dhe aktivitete të ndryshme. Të paraburgosurit janë vendosur nga 1 për dhomë dhe në një dhomë tjetër 2 të tjerë. Gjithësej ndodheshin 4 të paraburgosur. Inventari nëpër dhoma është i plotësuar (krevate, tavolina, dollape etj.) por kushtet brenda dhomave janë të mjerueshme dhe jo brenda standarteve të jetësës. Mungon ajrosja e mjaftueshme për shkak të pozicionit të ndërtesës, dritareve shumë të vogla dhe në një lartësi shumë të madhe, disa dhoma të cilat janë të vogla ku mungonin dhe shtretërit dhe korridore të ngushta.

Në dhoma ka ndricim natyror dhe artificial. Dritaret janë të vogla dhe problem ngelet lagështira për vetë faktin se godina e paraburgimit është tejet e vjetër dhe e amortizuar. Shumica e ndërresave dhe shtresave të gjumit si carcafë, batanije laheshin dhe ishin sjellë nga familjarët. Dyshekët ishin prej sfungjeri dhe në kushte disi të mira.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte siguruar, gjë që bënte të mundur aksesin e personave për të kryer normalisht nevojat e tyre por problem madhor ishte dushi i cili ndodhej brenda tualetit dhe në kushte shumë të këqija. Sipër tualetit ndodhej dushi me një aksesori në kushte jo të mira. Bolieri i ujit të ngrohtë ishte i montuar jashtë godinës por nga kontrolli që ne i bëmë ujit rezultoi që uji i ngrohtë nuk mungonte.

Problematike dhe mjaft shqetësuese ngeleshin kabujt dhe telat e energjis elektrike të cilat ishin tejet të amortizuar dhe përbënin një kërcënim për jetën e vetë stafit dhe të paraburgosurve brenda këtij institucioni.

Gjatë dimrit ngrohja realizohet me sobë me dru ndërsa në verë nuk ka një mjet ftohje që të plotësojë kërkesat e të gjithë institucionit megjithëse konsiderohej si godinë e freskët në verë për shkak dhe të mungesës së rrahje së saj nga rrezet e diellit.

Për sa i përket pajisjeve elektroshtëpiake në një nga dhomat ku ndodheshin dy të paraburgosur kishte dhe TV ndërsa elektroshtëpiake të tjera nuk u vunë re. Mungonin mjediset e jashtme të cilat mund të përdreshin për aktivitete sportive si futboll, basketboll etj. I vetmi ambjent ishte ambjenti i ajrimit i cili ishte i kufizuar në hapsirë dhe nuk ofronte asnjë mundësi argëtimi për aktivitetet sportive. Të paraburgosurit luanin kryesisht shah dhe domino.

Brenda regjimit nuk kishte një sallë për bibliotek megjithëse ajo ekzistonte dhe ishte e vendosur në godinën e re por brenda zyrave të stafit psiko-edukativ. Punonjësi Social merrej me pasurimin e bibliotekës i cili informonte të

paraburgosurit rreth librave që gjendeshin në bibliotek dhe më pas sipas kërkesave të tyre ai ua sillte këtyre të fundit librat brenda regjimit dhe ata i lexonin.

## **Higjena**

Dhoma dhe korridoret ishin kryesisht të pastra të palyera për një kohë shumë të gjatë dhe me lagështirë. Tualeti është i përbashkët ku në të ndodhet 1 wc alla turka dhe dushi që ndodhej i vendosur po aty. Nga inspektimi jonë tualeti ishte në kushte mjaft të këqija me nivel të lartë lagështie i cili nuk ploteson asnjë nga standartet e kushteve të jetesës brenda këtij institucioni. Nga inspektimi jonë në momnetin e kontrollit nuk mungonte uji i ngrohtë. Kalendari i dusheve nuk ndodhej i afishuar por nga pohimet e të paraburgosurve na u konstatua se nuk kishte pengesa dhe kufizime në bërjen e dusheve. Çarçafët ndërrohen njëherë në 15 ditë, ndërsa problem ngelet lavaneria për larjen e rrobave personale të të paraburgosurve të cilat dërgohen në shtëpitë e tyre dhe lahen nga familjaret.

## **Kuzhina**

Nga vizita në kuzhinën e IEVP-së u vu re që është e vogël por me kushte shumë të mira. Kjo godinë ndodhej jashtë godinës së institucionit dhe ishte e përbashkët me Komisariatit e Policisë së Bajram Currit. Ajo ishte e vendosur nën tokë megjithëse ishte e pastër dhe nuk mungonin paisjet e domosdoshme për gatim dhe mirëmbajtjen e ushqimeve në kushte shumë të mira. Ushqimi i përgatitur ishte i cilësisë së kënaqshme dhe pastër. Në të punon një kuzhinierë dhe një ndihmës kuzhinier. Ambjentet e saj janë të pastra. Në kuzhinë gjendet e afishuar menuja ditore. Gramaturat dhe kaloritë janë brenda standarteve. Kampionët e ushqimeve të gatuar një ditë më parë ruhen në kushte frigoriferike. Pothuajse të gjithë të dënuarit e konsumojnë ushqimin në institucion dhe na pohuan se është i kënaqshëm për nga cilësia dhe shija i vetmi problem ngelet larmishmëria. Nuk ka raste të refuzimit të ushqimit.

## **Orari veprimeve dhe aktivitetet**

Orari i veprimeve, përfshirë këtu zgjimin, rregullimin e pastrimin e dhomave dhe ambientit të përbashkët, punës edukative e profesionale etj, ishte i afishuar. Aktivitetet fillonin në orën 07.00 dhe mbylleshin në orën 22.30.

Në lidhje me ajrimin, përvec bisedës me të paraburgosurit, u kërkua informacion nga stafi dhe rezultoi se të paraburgosurit qëndrojnë 3 orë në ajrim, 2 orë paradite dhe 1 orë pasdite. Në ambiente e ajrimit zhvilloheshin lojra si shah, domino, letra etj kryesisht lojra tavoline. Ndërsa gjatë dimrit këto aktivitete zhvillohen në dhoma për arsye se brenda regjimit mungonin hapësirat e nevojshme.

Nga takimi me stafin e sektorit të kujdesit social u vu re një komunikim dhe bashkëpunim shumë i mirë. Vetë punonjësi social na shoqëroi gjatë gjithë inspektimit dhe na informoi për aktivitetet, temat e ndryshme dhe programet që zbatoheshin në institucion si dhe pamë me zgjedhje disa dosje psiko-sociale të të paraburgosurve. Dosjet psiko-sociale ishin të plotësuara shumë mirë, me

përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarit, me programet individuale dhe në grup, me vlersimet e tre mujoreve dhe gjithë dokumentat e tjera mbështetëse.

### ***Shërbimi Shëndetësor***

Organika e sektorit shëndetësisë përbehej nga një mjek me kohë të plotë dhe tre ndihmës mjek. Ndërkohë që mungonte farmacisti, punën e tij e mbulonte mjekja e këtij institucioni.

Nga të katër të paraburgosurit që gjendeshin në këtë institucion vetëm njëri vuante nga HTA dhe Hipertrofi të Prostatës, i cili e siguronte nga familja mjekimin për këto sëmundje.

Gjatë kësaj vizite monitoruese, u vu re se asnjëri nga personat që ndodhej në këtë institucion nuk ishte i pajisur me librezë shëndetësore e rrjedhimisht skema e rimbursimit të ilaçeve nuk funksiononte. Gjithashtu vështirësi kishte edhe në kryerjen e konsultave në spitalin rajonal, sidomos për shkak të mungesës së specialistëve në këtë spital.

Shërbimi stomatologjik mbulohej privatisht një dentiste shkolle, e cila është kontraktuar nga institucioni. Ky i fundit rimbursonte çdo shpenzim për shërbimin dentar që i bëhej të paraburgosurve.

Për sa i përket dhomës së mjeku dhe të farmacisë ato ishin të rregullta por në kushte tejet të amortizuara. Farmacia ishte e furnizuar me medikamente të urgjencës.

Nga këqyrja e të gjithë dokumentacionit të këtij sektori konstatoam se, ato mbaheshin me rregull. Kartelat plotësoheshin duke patur një ndjekje në dinamikë të rasteve me probleme shëndetësore. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për regjistrat e vizitave dhe të konsultave. I gjithë dokumentacioni mbahej me dry.

### **Masat mbrojtëse**

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve cdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej. Regjistrat mbaheshin nga sekretarja e protokollit në një zyrë të vecantë.

Dhoma e vecimit kishte të njëjtat kushte me dhomat e tjera hapsirë e vogël, pa krevat, jo e pastër. Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë person në vecim apo me masë disiplinore e cila u konfirmua dhe nga bisedat konfidenciale me vetë të paraburgosurit por dhe nga verifikimi i rrejstrave të masave disiplinore. Nga vëzhgimi në dhomën e vecimit u vu re një kabull i cili varej deri poshtë afër dyshëmes. Nga punonjësi i regjimit të brendshëm u pohua se ajo dhomë ishte përdorur më përpara jo për vecim dhe se aty kishte pasur TV nga një i paraburgosur tjetër ku kabulli është lënë për këtë arsye.

Për hartimin e ankesë/kërkesave ka një format të veçantë por në I.E.V.P. nuk ka kuti ku ankesë/kërkesat të vendosen në mënyrë anonime. Ato i dorëzohen stafit të edukimit të hapura dhe pasi tërhiqen prej tij, seleksionohen në drejtori për të përcaktuar destinacionin e tyre.



Telefonat punonin në çdo kohë dhe të dënuarit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit.

Për sa i përket takimeve ka një ambjente në të cilin të paraburgosurit mund të takohen me familjarët e tyre. Keto ambjente janë të hapura të pajisur me një tavolinë dhe disa karrige të vjetra në kushte jo shumë të mira. Nuk kishte ankesa prej të paraburgosurve për sa i përket takimeve, ato zhvillohen në rregull sipas planifikimeve dhe survejoheshin në distancë nga punonjës të sigurimit. Në dhomën e takimeve mungonin sende dhe orendi që krijojnë klimën e një takimi familjar në respekt të dinjitetit të të dënuarve dhe familjarëve vizitorë në institucion.

Sa i përket çështjes së sigurisë, në regjim kishte kamera të jashtme dhe të brendshme që survejonin institucionin për 24 orë por që ishin jashtë shërbimit dhe nuk funksiononin.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të Nenit 74/1 pika “b” të Ligjit Nr. 9888 dt. 10.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8328 dt. 16.04.1998 Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarave me burgim”* ku parashikohet midis të tjerash se: *“Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:*

*b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtërues”.*

### **REKOMANDOJMË:**

1. Të kryhen riparimet dhe ndryshimet e nevojshme për të mundësuar kalimin sa më të shpejtë të të paraburgosurve në ambientet e reja të I EVP Tropojë.
2. Të aktivizohen kurse të formimit arsimor e profesional.
3. Të merren masa për mbështetje me bazë materiale e financiare për të mundësuar realizimin e aktiviteteve e veprimtarive me karakter edukativ, social, artistik, kulturor e fetar.
4. Të gjenden modalitetet që marrëveshja tre palëshe për medikamentet të funksionojë edhe në I EVP- të cilat janë të vendosura në zona ku nuk ka depo farmaceutike.

5. Marrjen e masave urgjente për shtimin në organikë të farmacistit në sektorin shëndetësor.
6. Marrjen masave urgjente për furnizimin me medikamente të farmacisë së IENP-së, si për sëmundjet kronike ashtu edhe ato akute.
7. Marrjen e masave për pajisjen e të dënuarve me libreza shëndetësore dhe vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve.
8. Vleresimin e ligjshmerisë së procedurës së vendosjes së dhomave të sigurisë së Komisarariatit të Policisë Bajram Curr në ambjentet e IEVP Bajram Curr me prezencë të dyfishtë të personelit policorë.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit".

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**

**Në mungesë dhe me Porosi**

**K O M I S I O N E R I**

**Arben SHKËMBI**

